

KOMISIONI I DISIPLINËS VENDIM Nr. 4

Nr. 36 Prot.

11 Prill 2025

Më datë **11 Prill 2025**, u mbledh **Komisioni i Disiplinës** i Federatës Shqiptare të Basketbollit, nën drejtimin e kryetarit, **z. Klevis Kaso**, me praninë e anëtarëve, **z. Ersi Oruci** dhe **z. Klaudio Ndoja**, për shqyrtimin e problematikës të ndodhur në ndeshjen e Kampionatit Kombëtar Superliga Meshkuj, Besëlidhja vs Vllaznia, ndeshja e parë e fazës ½ Finale, datë 9 Prill 2025, në pallatin e sportit "Asllan Rusi".

Pas shqyrtimit të materialeve përkatëse, përfshirë relacionin e vëzhguesit të ndeshjes, si dhe në bazë të **Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, **Komisioni i Disiplinës** vendosi:

1. **Përgjashtim 6 muaj nga të gjitha aktivitetet e FSHB-së për z. Albert Ndreu**, bazuar në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit, neni 14.12:

"Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtarë, trajnerë, etj.), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj.) apo pjesëmarrësve të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes."

2. **Sanksion financiar në vlerën 100.000 lekë për z. Albert Ndreu**, bazuar në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit, neni 14.12:

"Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtarë, trajnerë, etj.), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj.) apo pjesëmarrësve të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes."

3. **Përgjashtim 12 muaj nga të gjitha aktivitetet e FSHB-së për z. Erion Lleshi (rast i përsëritur)**, bazuar në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit, neni 14.12:

"Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtarë, trajnerë, etj.), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj.) apo pjesëmarrësve të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes."

4. **Sanksion financiar në vlerën 200.000 lekë për z. Erion Lleshi (rast i përsëritur)**, bazuar në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit, neni 14.12:

"Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtarë, trajnerë, etj.), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj.) apo pjesëmarrësve të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes."

5. **Sanksion financiar në vlerën 100.000 lekë për Shoqatën Besëlidhja Eagles Basket, si përgjegjëse për dhunën e ushtruar**, bazuar në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit, neni 14.12:

“Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtarë, trajnerë, etj.), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj.) apo pjesëmarrësve të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes.”

E Drejta për Ankimim

Sipas **nenit 11.8 të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda **72 orëve** nga marrja e vendimit. Ankimi duhet të dorëzohet pranë **Komisionit të Apelit të FSHB-së** dhe të shoqërohet me vërtetimin e pagesës prej **10,000 lekësh** në arkën e FSHB-së.

Një kopje e kërkesës së ankimit i dërgohet palëve të përfshira. **Komisioni i Apelit** shqyrton çdo vendim të **Komisionit të Disiplinës** që kontestohet nga palët e interesuara.

Vendimet e **Komisionit të Apelit** mund të ankimohen pranë **Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS)**.



Klevis Kaso
Kryetar



Ersi Oruçi
Anëtar



Klaudio Ndoja
Anëtar